

Udhëzues për personelin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë që ka udhëtuar jashtë Shqipërisë gjatë 2 javëve të fundit.

Duke pasur parasysh përmasat e përhapjes së COVID-19 dhe shpalljen nga Organizata Botërore e Shëndetësisë të pandemisë globale, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura ka përgatitur udhëzuesin për personat që kanë udhëtuar në vende të prekura nga COVID-19.

Udhëzimet për COVID-19 janë të vlefshme për të gjithë personelin e FARSH. Ky dokument ofron informacion për të gjithë personelin i cili ka udhëtuar më herët në zonat e prekura dhe për ata që do të udhëtojnë në ditët në vazhdim.

Masa për personelin e FARSH

Masa në momentin e mbërritjes në Shqipëri:

Degët e Personelit të Komandave dhe Reparteve, duhet të evidentojnë të gjithë personelin (civil apo ushtarak), i cili ka udhëtuar në vendet e prekura me COVID-19, në hapësirën kohore prej 14 ditësh, duke përfshirë personelin i cili ka udhëtuar me mjete udhëtimi të ndryshme ushtarake apo civile. Stukturat duhet të vendosin këtë personel nën një kufizim lëvizjeje për 14 ditë (vetë-karantinim në shtëpi). Gjatë kufizimit (fillon që nga dita e nisjes nga shteti):

- Personeli i FARSH duhet të qëndrojë në shtëpi apo ambiente të tjera të mbyllura për 14 ditë duke kufizuar kontaktet e afërta (në një distancë prej 2 metrash) me persona të tjerë dhe duke ndjekur në mënyrë strikte rregullat e higjenes. Gjithashtu duhet të raportojë çdo ditë në repart gjendjen shëndetësore.
- Personeli ushtarak apo civil duhet të vetëmonitorohet duke matur temperaturën 2 herë në ditë, dhe nëse paraqesin ndonjë nga simptomat, vecanërisht temperaturë, simptoma respiratore si kollë dhe vështirësi në frymëmarrje apo diarre, duhet të kontaktojë menjëherë në numrin 127, të vendosur në dispozicion nga Qendra Kombëtare e Emergjencës Mjekësore, të kufizojë kontaktet me të tjerët dhe të informojë drejtuesit e tyre.
- Personeli ushtarak apo civil duhet të veçojë vetveten nga pjesëtarët e familjes (kur kjo është e mundur), dhe të shmangë ndarjen e mjeteve personale.
- Personeli nuk duhet të udhëtojë, të vizitojë ambiente publike, apo të përdorë transportin publik dhe duhet të shmangë ndërveprimet me kafshët shtëpiake apo kafshë të tjera.
- Raportimi duhet të jetë i menjëhershëm nëse një ushtarak apo civil pjesëtar i FARSH shfaq simptoma të dyshuara për COVID-19.
 - Personeli i FARSH më parë duhet të telefonojë shërbimin mjekësor (127) dhe ti shpjegojë stafit mjekësor simptomat e tij/saj. Të shpjegojë dhe historikun e udhëtimit. Më pas duhet të verë në dijeni drejtuesit e tij.
 - Strukturat e FARSH duhet të raportojnë për çdo efektiv që është duke u vlerësuar si rast i dyshuar për COVID-19.

- Personeli i FARSH duhet të rapotojë pranë reparteve në qoftë se ka ardhur në kontakt me persona me COVID-19 vërtetuar nga institucioni i autorizuar.

Udhëzimet i referohen udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.